



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

Dokument i Komisionit

VENDIM

Nr. 16, Datë 28.09.2015

**"Për një shtesë në vendimin nr.7 dt.23.01.2015 të Komisionit të Posaçëm, i ndryshuar
"Për miratimin e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm
Parlamentar"**

Bazuar në nenet 24 dhe 32-41 të Regullores se Kuvendit, në pikën VII të vendimit Nr.96/2014, Dt. 27.11.2014 të Kuvendit të Shqipërisë "Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë", si dhe në vendimet Nr.2 dhe Nr.3, dt.22.12. 2014 të këtij Komisioni, me propozim të Kryetarit, Komisioni i Posaçëm:

VENDOSI :

Në aneksin 1 të vendimit nr. 7 dt.23.01.2015 "Për miratimin e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar", i ndryshuar, të Komisionit Posaçëm, bëhen këto ndryshime:

1. Të shtohen si anëtarë të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë, ekspertët vendas, Tritan Hamitaj dhe Marsida Xhaferllari, të propozuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

Fatmir XHAFAJ